



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT
MINISTARSTVO KULTURE I TURIZMA
MINISTRY OF CULTURE AND TOURISM



AGJENCIA SHETËTORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS

DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA

STATE ARCHIVES AGENCY OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E KULTURËS, RIMISË DHE SPORTIT / MINISTARSTVO KULTURE I TURIZMIT
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
AGJENCIA SHETËTORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS / DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA
STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES

Nr./Br./No.

01/26-9/24

Data/Datum/Date:

20.04.2025



RAPORT VJETOR I PUNËS 2025

Prishtinë, 2026

RAPORT VJETOR I PUNËS

2025

Përmbajtja

1. FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV	3
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
3. AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE.....	4
4. STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	6
5. BURIMET NJERËZORE.....	6
6. INFRASTRUKTURA DHE KAPACITETET FIZIKE.....	7
6.1 <i>Renovimi i objektit të ASHAK</i>	7
6.2 <i>Hartimi i Projektit për ndërtimin e Arkivit Ndërkomunal në Gjilan</i>	8
6.3 <i>Funksionalizimi i Kazermës së Vjetër në Prizren për Arkivin Ndërkomunal të Prizrenit</i>	9
6.4 <i>Renovimi i Depos në Arkivin Ndërkomunal të Pejës</i>	10
6.5 <i>Funksionalizimi i objektit të ri për Arkivin Ndërkomunal të Gjakovës</i>	10
7. RREGULLIMI, KLASIFIKIMI DHE PËRGATITJA E DOKUMENTEVE PËR DIGJITALIZIM.....	11
8. DIGJITALIZIMI I MATERIALIT ARKIVOR.....	14
9. ZHVILLIMI DHE ADMINISTRIMI I VEPRIMTARISË HULUMTUESE ARKIVORE.....	15
10. SHËRBIMI I QYTETARËVE ME DOKUMENTE ARKIVORE.....	16
11. BIBLIOTEKA E ARKIVIT	16
12. INSPEKTIMI DHE PRANIMI I LËNDËS ARKIVORE DHE TE FONDKRIJUESIT.....	17
12.1 <i>Inspektimi i institucioneve fondkrijuese</i>	17
12.2 <i>Pranimi i materialit arkivor</i>	18
12.3 <i>Lista me afate të ruajtjes</i>	18
13. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR.....	19
13.1 <i>Marrëveshje bashkëpunimi</i>	19
13.2 <i>Konferenca ndërkombëtare</i>	20
13.3 <i>Takime dhe vizita zyrtare</i>	23
14. PROMOVIMI I VEPRIMTARISË ARKIVORE	26
14.1 <i>Ekspozita</i>	22
14.2 <i>Botime dhe promovime</i>	28
14.3 <i>Panairi i librit</i>	30
14.4 <i>Java e Arkivit të Hapur</i>	31
15. PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM	34
16. BUXHETI DHE FINANCAT.....	35
17. PROKURIMI.....	36

1. FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV

Viti 2025 shënoi një periudhë të rëndësishme të avancimit institucional dhe profesional në fushën e veprimtarisë arkivore në kuadër të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Në kuadër të forcimit të kornizës ligjore dhe profesionale, janë hartuar dhe avancuar akte nënligjore, udhëzues metodikë dhe dokumente planifikuese që synojnë unifikimin e praktikave profesionale në rregullimin, digjitalizimin, restaurimin, konservimin dhe administrimin e materialit arkivor. Këto zhvillime kanë ndikuar në standardizimin e proceseve të punës dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve arkivore.

Kanë vazhduar investimet në infrastrukturën arkivore, duke realizuar renovimin dhe funksionalizimin e hapësirave në objektin qendror, renovimin e depos së Arkivit Ndërkomunal në Pejë, funksionalizimin e objektit për ANK në Gjakovë, si dhe vazhdimin e punimeve në objektin e ish Kazermës së Vjetër në Prizren. Paralelisht, është avancuar edhe projekti për ndërtimin e Arkivit Ndërkomunal në Gjilan. Këto investime synojnë krijimin e kushteve më të sigurta dhe më bashkëkohore për ruajtjen e materialit arkivor.

Në fushën e rregullimit dhe përgatitjes së materialeve për digjitalizim janë shënuar rezultate të rëndësishme, ku qindra metra gjatësi lineare të materialit arkivor me miliona faqe janë sistemuar dhe përgatitur për trajtim digjital. Digjitalizimi ka vazhduar të mbetet një nga shtyllat kryesore të zhvillimit institucional, ku edhe në vitin 2025 janë realizua mbi 4 milion imazhe të materialeve arkivor.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme të vitit ishte funksionalizimi i Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Materialeve Arkivore – SEMMA, përmes të cilit janë integruar të dhëna për fonde dhe koleksione arkivore. Ky sistem mundëson menaxhim më efikas, transparent dhe të standardizuar të materialit arkivor, duke përmirësuar edhe qasjen e publikut në dokumentacionin arkivor.

Përveç aktiviteteve profesionale, Agjencia ka vazhduar angazhimin në shërbim të qytetarëve përmes inspektimeve arkivore, pranimit të materialeve nga fondkrijuesit, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si dhe organizimit të ekspozitave, botimeve, konferencave dhe aktiviteteve në kuadër të Javës së Arkivit të Hapur.

Të gjitha këto aktivitete pasqyrojnë përkushtimin e vazhdueshëm të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës në ruajtjen, mbrojtjen, digjitalizimin dhe promovimin e trashëgimisë dokumentare të Republikës së Kosovës.

**U.D. Drejtor Ekzekutiv i AShAK
Bekim ALIU**

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (AShAK) është organ qeveritar që vepron në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-111 për Arkivat. Si institucioni përgjegjës për menaxhimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e sistemit arkivor në nivel shtetëror, mandati i saj buron nga legjislacioni në fuqi, duke e përcaktuar atë si garantuese të ruajtjes së trashëgimisë dokumentare të Republikës së Kosovës. AShAK është e përkushtuar të sigurojë ruajtjen e sigurt të materialeve arkivore, të ofrojë qasje për publikun dhe të promovojë rëndësinë e dokumenteve historike si pasuri kombëtare.

Vizioni i AShAK-së përfshin përmirësimin e kushteve infrastrukturore, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e materialeve arkivore, mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për menaxhimin e dokumenteve dhe arkivave në të gjitha institucionet publike dhe private, si dhe krijimin e një arkivi digjital kombëtar që mundëson qasje të lehtë dhe të sigurt në dokumente historike dhe administrative. AShAK synon të ofrojë qasje cilësore në materialet arkivore për studiues, historianë dhe publikun e gjerë, duke krijuar platforma për shërbime digjitale që lehtësojnë kërkimet arkivore për nevoja profesionale, shkencore, publicistike dhe për nevoja të tjera të qytetarëve apo institucioneve vendore dhe më gjerë.

Raporti i punës për vitin 2024 pasqyron arritjet e Planit të Punës 2024, pavarësisht sfidave të shumta me të cilat u përballëm gjatë vitit, siç janë: kushtet jo adekuate infrastrukturore, mungesa e pajisjeve teknologjike, mungesa e burimeve njerëzore, etj. Gjatë vitit 2024, AShAK ka punuar në përputhje me Planin e Punës dhe vendimet e nxjerra nga Drejtori Ekzekutiv.

3. AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE

Gjatë vitit raportues, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (AShAK) ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në konsolidimin dhe avancimin e kornizës strategjike dhe nënligjore në fushën e arkivistikës, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 08/L-111 për Arkivat.

Në këtë kontekst, **Strategjia Shtetërore për Arkiva** ka përfunduar të gjitha procedurat administrative dhe ligjore të parapara, duke përfshirë procesin e hartimit, konsultimeve dhe harmonizimit institucional. Aktualisht, dokumenti ndodhet në fazën përfundimtare, në pritje të dërgimit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Qeveri për miratim.

Po ashtu, në zbatim të dispozitave ligjore dhe në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale në sektorin arkivor, gjatë vitit 2025 është miratuar *Rregullorja (QRK) nr. 02/2026 për programin, përmbajtjen, mënyrën dhe procedurat e organizimit të trajnimit profesional për zyrtarët arkivor*. Kjo rregullore krijon bazë të qëndrueshme për standardizimin e trajnimeve dhe zhvillimin profesional të stafit arkivor në nivel vendi.

Në kuadër të plotësimit të mëtejme të kornizës nënligjore, kanë kaluar të gjitha procedurat e nevojshme dhe aktualisht janë në pritje të miratimit nga Ministri dy akte të rëndësishme rregullative:

- Draft-Rregullorja e MKRS-së nr. XX/2024 për kushtet, kriteret dhe procedurat e nxjerrjes së materialit arkivor jashtë Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës”, e cila synon të rregullojë në mënyrë të detajuar procedurat dhe standardet për trajtimin e materialit arkivor jashtë institucionit, duke garantuar sigurinë dhe integritetin e tij;
- Draft-Rregullorja (MKRS) nr. XX/2024 për dhënien e pëlqimit për themelimin e arkivave private”, e cila përcakton kriteret dhe procedurat për autorizimin dhe mbikëqyrjen e arkivave private, në funksion të harmonizimit me standardet shtetërore dhe mbrojtjes së trashëgimisë dokumentare.

Këto iniciativa dhe akte rregullative dëshmojnë angazhimin e vazhdueshëm të AShAK për përmbushjen e obligimeve ligjore, forcimin e infrastrukturës normative dhe avancimin e standardeve profesionale në ruajtjen, menaxhimin dhe promovimin e materialit arkivor në Republikën e Kosovës.

Në funksion të zbatimit praktik të akteve nënligjore dhe standardizimit të proceseve të punës në sistemin arkivor, janë hartuar dhe miratuar tre udhëzues metodikë të punës, të cilët rrjedhin nga rregulloret e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.


Udhëzuesit e miratuar janë:

- **Udhëzuesi Metodik për Rregullimin e Materialit Arkivor**, i cili përcakton standardet dhe procedurat për klasifikimin, sistemimin dhe përshkrimin e materialit arkivor, me qëllim sigurimin e një trajtimi të unifikuar dhe profesional të fondeve dhe koleksioneve arkivore;
- **Udhëzuesi Metodik për Digjitalizimin e Materialit Arkivor**, i cili rregullon aspektet teknike dhe procedurale të procesit të digjitalizimit, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes, standardet e cilësisë, ruajtjen dhe menaxhimin e kopjeve digjitale;
- **Udhëzuesi Metodik për Konservimin dhe Restaurimin e Materialit Arkivor**, i cili përcakton parimet dhe procedurat për mbrojtjen fizike, trajtimin dhe restaurimin e materialit të dëmtuar, në përputhje me standardet profesionale dhe praktikatat bashkëkohore në fushën e konservimit.

Miratimi i këtyre udhëzuesve përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së cilësisë së shërbimeve arkivore, unifikimit të praktikave profesionale dhe forcimit të kapaciteteve institucionale për menaxhimin e qëndrueshëm të trashëgimisë dokumentare.

4. STRUKTRA ORGANIZATIVE

Struktura organizative e ASHAK përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv, Zëvendës Drejtori Ekzekutiv, shtatë (7) departamente, dhe njëzet e gjashtë (26) divizione.



Struktura Organizative e ASHAK

5. BURIMET NJERËZORE

Ka përfunduar procesi i ristrukturimit dhe sistematizimit të vendeve të punës në ASHAK, në përputhje me Rregulloren (ZKM) nr. 16/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Në këtë kuadër, janë nxjerrë dhe nënshkruar akt-emërimet dhe vendimet për të gjithë stafin e ASHAK-ut, në përputhje me strukturën e re organizative.

Gjithashtu, me qëllim të plotësimit të strukturës organizative me kuadër profesional, bazuar në nevojat e identifikuara, janë zhvilluar gjithsej 8 procedura rekrutimi, prej të cilave 3 janë përmbyllur, ndërsa 5 janë në proces të finalizimit.

Aktualisht, në ASHAK janë të punësuar 104 zyrtarë, të cilët sigurojnë funksionimin dhe realizimin e veprimtarisë institucionale.

Në funksion të menaxhimit efikas të burimeve njerëzore, është siguruar mirëmbajtja dhe funksionimi i sistemit elektronik për menaxhimin e pushimeve dhe vijueshmërisë në punë për

zyrtarët e AShAK-ut, si dhe janë realizuar detyra të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Trajnimet profesionale

Me qëllim të forcimit të kapaciteteve profesionale, si dhe ngritjes së aftësive teknike të stafit, gjatë vitit 2025 janë realizuar një sërë aktiviteteve trajnuese të rëndësishme:

- Janë organizuar trajnime për stafin menaxherial dhe profesional arkivor për përdorimin e Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Materialeve Arkivore (SEMMA). Këto trajnime kanë përfshirë të gjitha modulet e sistemit dhe kanë synuar avancimin e aftësive për një menaxhim bashkëkohor dhe efikas të dokumentacionit arkivor.
- Është realizuar trajnim për inspektorët arkivorë pranë Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm, me fokus në harmonizimin e procedurave inspektuese në përputhje me reformat e reja ligjore dhe metodologjike në fushën e inspektimit arkivor.
- Gjithashtu, 17 zyrtarë kanë ndjekur gjithsej 9 trajnime profesionale të organizuara nga IKAP dhe Thesari, duke u aftësuar në fusha të rëndësishme si: planifikimi strategjik, treguesit e performancës, udhëzimet administrative për planifikimin dhe ndryshimet buxhetore, funksionimi i Njesisë Qendrore Harmonizuese, zhvillimi i politikave publike efektive, procedurat e prokurimit, zbatimi i Planit Kombëtar për Zhvillim, sistemi i menaxhimit të performancës, politikat e konkurrencës, menaxhimi i kontratave, disiplinimi dhe ankimimi në Shërbimin Civil, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), si dhe menaxhimi i projekteve të TIK-ut.

6. INFRASTRUKTIURA DHE KAPACITETET FIZIKE

Në kuadër të sigurimit të kushteve optimale për zhvillimin e veprimtarisë arkivore, gjatë periudhës raportuese është kushtuar vëmendje e veçantë përmirësimit të infrastrukturës fizike në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (AShAK). Investimet dhe ndërhyrjet e realizuara kanë qenë të orientuara drejt rritjes së kapaciteteve funksionale, përmirësimit të kushteve të ruajtjes së materialit arkivor dhe krijimit të një ambienti më të përshtatshëm për punën e stafit dhe shërbimet ndaj publikut.

6.1 Renovimi i objektit të AShAK

Ka përfunduar projekti i renovimit të AShAK kati i parë dhe oborri. Me këtë renovim u siguroa hapësirë funksionale, e sigurt dhe efikase për arritjen e objektivave. Ky investim kontribuoi në ruajtjen e trashëgimisë kombëtare dhe ofron kushte më të mira pune për zyrtarët, si dhe për studiuesit, historianët e publikun. Institucioni mbetet i përkushtuar për të garantuar cilësinë e punimeve në vijim, duke siguruar një mjedis bashkëkohor për arkivat kombëtare.

*Gjate procesit të renovimit**Pas përfundimit të renovimit*

6.2 Hartimi i Projektit për ndërtimin e Arkivit Ndërkomunal në Gjilan


Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për modernizimin dhe zgjerimin e kapaciteteve arkivore në Kosovë, gjatë periudhës raportuese është arritur një progres i rëndësishëm në realizimin e projektit strategjik për ndërtimin e Objektivit të Arkivit Ndërkomunal në Gjilan. Pas përfundimit me sukses të procedurave të tenderimit, është finalizuar kontrata kryesore e projektit, ndërkohë që janë përmbyllur të gjitha përgatitjet e nevojshme dokumentare dhe është siguruar Leja e Ndërtimit për këtë objekt.

Ky projekt përbën një hap të rëndësishëm drejt avancimit të infrastrukturës institucionale në fushën e arkivistikës, duke synuar përmirësimin e kushteve për ruajtjen, administrimin dhe promovimin e dokumentacionit historik dhe kulturor me rëndësi të veçantë kombëtare. Me finalizimin e kontratës, është krijuar baza e qëndrueshme për fillimin e punimeve ndërtimore të Arkivit Ndërkomunal në Gjilan, i cili do të shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 4,100 m².

Objekti i planifikuar është konceptuar në përputhje me standardet bashkëkohore për menaxhimin e materialit arkivor dhe do të përfshijë këto komponentë funksionalë kryesorë:

- Depo moderne për ruajtjen e materialeve arkivore, të pajisura me sisteme të avancuara klimatike dhe sigurie;
- Salla muzeale dhe hapësira ekspozuese për prezantimin e trashëgimisë dokumentare;
- Salla për prezantim dhe hulumtim, të dedikuara për studiues dhe akademikë;
- Bibliotekë arkivore me fond të pasur literaturor në fushën e arkivistikës dhe historisë;
- Hapësira administrative dhe zyra pune për zhvillimin e veprimtarisë profesionale të institucionit.

Realizimi i këtij investimi strategjik pritet të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve për menaxhimin dhe ruajtjen e dokumenteve me vlerë historike, duke garantuar kushte optimale sipas standardeve bashkëkohore dhe duke kontribuar në promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë arkivore në nivel kombëtar.



Projekti për ndërtimin e Arkivit Ndërkomunal në Gjiçan

6.3 Funkcionalizimi i Kazermës së Vjetër në Prizren për Arkivin Ndërkomunal të Prizrenit

Ka vazhduar procesi i restaurimit dhe adaptimit të objektit të Kazermës së Vjetër në Prizren, i cili do të vihet në shfrytëzim afatgjatë nga Arkivi Ndërkomunal i Prizrenit. Punimet janë zhvilluar në përputhje me dinamikën e përcaktuar në kontratë, duke respektuar standardet më të larta profesionale për konservimin dhe restaurimin e objekteve me vlerë historike dhe kulturore.

Ky projekt përfaqëson një ndërhyrje të rëndësishme në ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike, duke synuar njëkohësisht transformimin funksional të kësaj ndërtese historike në një hapësirë moderne dhe të përshtatshme për veprimtarinë arkivore.

Pas përfundimit të punimeve, objekti i Kazermës së Vjetër do të rikthejë funksionalitetin e tij përmes adaptimit në një qendër të mirëfilltë arkivore, e cila do të shërbejë për grumbullimin, ruajtjen, përpunimin dhe promovimin e dokumentacionit me rëndësi historike për rajonin e Prizrenit. Në këtë mënyrë, projekti pritet të kontribuojë ndjeshëm në forcimin e infrastrukturës arkivore në nivel vendi, si dhe në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Prizrenit, si një nga qendrat me vlera të veçanta historike dhe kulturore.



Nga punimet në renovimin e ANK – Prizren

6.4 Renovimi i Depos në Arkivin Ndërkomunal të Pejës

Është finalizuar me sukses projekti i nisur një vit më parë për renovimin dhe funksionalizimin e depos në objektin ekzistues të Arkivit Ndërkomunal në Pejë. Ky investim i planifikuar në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës arkivore ka pasur për synim krijimin e kushteve optimale për ruajtjen afatgjatë dhe të sigurt të materialit arkivor.

Punimet e realizuara kanë përfshirë një sërë ndërhyrjesh të rëndësishme, i cili përfshinë renovimin e hapësirës së depos, izolimin adekuat, instalimin dhe përmirësimin e sistemeve për kontrollin e temperaturës dhe lagështisë, si dhe ngritjen e standardeve të sigurisë fizike dhe mbrojtjes kundër faktorëve të jashtëm.

Si rezultat i këtij projekti, depoja tashmë plotëson kërkesat bashkëkohore për ruajtjen profesionale të dokumentacionit, duke siguruar një mjedis të kontrolluar dhe të qëndrueshëm. Përfundimi i këtij investimi përfaqëson një avancim të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve teknike dhe operationale të Arkivit Ndërkomunal në Pejë, si dhe kontribuon në garantimin e standardeve më të larta në menaxhimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë dokumentare.



Depo para renovimit



Depo pas renovimit

6.5 Funksionalizimi i objektit të ri për Arkivin Ndërkomunal të Gjakovës

Janë përmbyllur me sukses punimet e nisura në vitin paraprak për renovimin e objektit të siguar për shfrytëzim afatgjatë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, i destinuar për nevojat e Arkivit Ndërkomunal në Gjakovë. Ky projekt ka qenë i orientuar drejt krijimit të kushteve të përshtatshme infrastrukturore për zhvillimin e veprimtarisë arkivore në përputhje me standardet profesionale.

Ndërhyrjet e realizuara kanë përfshirë përshtatjen funksionale të hapësirave, përmirësimin e kushteve teknike të objektit, si dhe krijimin e bazës për organizimin efikas të materialit arkivor. Me përfundimin e këtyre punimeve, objekti tashmë është i gatshëm për fazën e pajisjes dhe funksionalizimit të plotë.

Vendosja e kësaj infrastrukture do të shënojë hapin përfundimtar drejt funksionalizimit të plotë të objektit, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve të Arkivit Ndërkomunal në

Gjakovë dhe në përmirësimin e standardeve për ruajtjen dhe administrimin e materialit arkivor.



Nga punimet në renovimin e ANK – Gjakovë

7. RREGULLIMI, KLASIFIKIMI DHE PËRGATITJA E DOKUMENTEVE PËR DIGJITALIZIM

AShAK administron dhe ruan rreth 9 kilometra gjatësi lineare të materialit arkivor, duke siguruar menaxhimin dhe mbrojtjen e kujtesës institucionale dhe historike të vendit.

Veprimtaria e AShAK përfshin rregullimin, përpunimin, konservimin dhe digjitalizimin e këtyre materialeve, duke u bazuar në standardet më të larta profesionale dhe teknike. Këto procese synojnë garantimin e ruajtjes afatgjatë dhe lehtësimin e qasjes për studiuesit dhe publikun.

Përgatitja e materialeve arkivore për digjitalizim ka qenë një ndër prioritetet kryesore të AShAK gjatë vitit 2025, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë dhe efikasitetin e këtij procesi. Gjatë kësaj periudhe janë rregulluar dhe përgatitë për digjitalizim gjithsej 720 metra gjatësi lineare të materialit arkivor, që përfshin 5 544 kuti, respektivisht 4 162 711 faqe. Kjo fazë përfshin sistemimin, përpunimin dhe krijimin e kushteve optimale për digjitalizimin e dokumentacionit. Krahas kësaj, janë realizuar edhe punë konservimi dhe restaurimi për 1201 faqe të formatit A3.

Më poshtë paraqitet Raporti i Punës për vitin 2025, i strukturuar sipas njësisë organizative të AShAK-së.

1.1 Rregullim, klasifikim dhe përgatitje e dokumenteve arkivore për digjitalizim

Departamenti i Arkivit Qendror- Divizioni i Rregullimit dhe Përpunimit ka rregulluar dhe përgatitë për digjitalizim **3 394636** faqe, përkatësisht 4074 kuti apo 492.40 m.gj nga fondet:

- Gjykata e Qarkut Prishtinë, njësia organizative penale, vitet 1964/1995;
- Gjykata Ekonomike e Kosovës - Njes.Org: Dega në Gjakovë (shkronjat C,Ç,E,J,K,L,LL,M,N,Nj,O,P,R,S,Sh,T,Th,U,V,Y,X,Xh,Z,);
- Gjykata Ekonomike e Kosovës, dega në Prishtinë, shkronjat B,C,E,F,M,LO,P,S,Sh,T,U,V;

- Gjykata Supreme e Kosovës, shkronjat C,Ç,E,J,K,L,LL,M,N,Nj,O,P,R,S,Sh,T,Th,U,V,Y,X,Xh,Z,ZH;
- Drejtoria Krahinore Pronësore – Juridike.
Koleksionet si në vijim:
- Minir Dushi; Esat Kamberi; Glisha Elezoviq; Isak Shema; Fehmi Pushkolli; Marenglen Verli; Fatmir Lama; Sinan Hasani; Agim Vinca; Ismet Dermaku; Fadil Hoxha; Dimitrije Paramendiq; Steva Dimitrijoviq; Dushan Nikiq; Dragi Moraqiq; Milenko Peruqa; Petar Milanoviq; Halil Alidemaj; Ramiz Bimishi; Ibish Neziri; Hakif Bajrami.
- Fondet1 me nr. 122, 575,430, 435, 154, 427, 160, 322, 574, 417, 37, 572, 34, 470,573, 411, 565, 481, 401, 418, 144, 504, 569, 544, 570, 531, 354, 420,576, 428, 55, 21, 577, 373, 578, 580, 579, 129, 372, 184, 29.



Nga procesi i përgatitjes së dokumenteve për digjitalizim

Arkivi Ndërkomunal Prishtinë - ka rregulluar dhe përpunuar 25.30 m. gj. (171 kuti me 127575 faqe), ka klasifikuar 9.07 m.gj. në fondet:

- *Gjykata Komunale Prishtinë*, vërtetime, kontrata– vitet 1984 dhe 1995-1998;
- *BVI* për arsim, edukim dhe kulturë, vitet 1979/1981.

Arkivi Ndërkomunal Gjakovë – ka rregulluar 16.21 m.gj (202 kuti me 97564 faqe) të materialit arkivor nga Fondet me numër të inventarit: 19; 21; 22; 23; 24; 25; 26; 27; 28; 29; 31; 32; 33; 35; 36; 37; 38; 40; 41; 42; 43; 44; 45; 46; 47; 48; 49; 50; 51; 52; 53; 54; 55; 56; 57; 58; 59; 61; 62; 63; 64; 65; 66; 67; 68; 69; 70; 71; 72; 73; 74; 75; 76; 77; 78; 79; 80; 81; 82; 83; 84; 85; 86; 87; 88; 90².

Arkivi Ndërkomunal Mitrovicë - ka rregulluar dhe përpunuar 62.82 m.gj të materialit arkivor në fondin:

- *BVI*, vitet 1959/1999.

¹ Për shkak të numrit të madh të fondeve e koleksioneve, të cilat kanë sasi të vogël të materialit, nuk janë vendor emërtime por vetëm numri i fondit arkivor.

² Për arsye se fondet kanë sasi të vogël të materialit, janë vendos në raport vetëm me numër të fondit. Raporti edhe me emër të fondeve është në Raportin e ANK - Gjakovë

Arkivi Ndërkomunal Prizren – klasifikuar, rregulluar dhe përpunuar 54 m. gj. (228 kuti me 243971 faqe), të materialit arkivor në këto fonde:

- SHFMU Mate Logoreci”, vitet 1972 – 1995;
- SHFMU “Ibrahim Fehmiu”, vitet 1990 – 2000;
- Gjinnazi “Jeta e Re” Suharekë, vitet 1966 – 1991;
- Gjinnazi "Jovanka Radivojeviq Kica", vitet 1972 – 1991;
- Këshilli popullor i Bellobradit, vitet 1946 – 1971;
- Këshilli popullor i Dragashit, vitet 1945 – 1967;
- Gjykata e Rrethit Prizren, vitet 1957 – 1969
- Ministria e Punëve të Brendshme, vitet 1945 – 1979;

Arkivi Ndërkomunal Gjilan - ka rregulluar dhe përpunuar 11.06 m.gj.(108 kuti me 75187 faqe), dhe ka ndarë për asgjësim 13.29 m.gj. të materialit arkivor në fondin:

- *Banka e Bashkuar e Kosoves(BANKKOS)-dega Gjilan.*

Arkivi Ndërkomunal Pejë - ka rregulluar dhe përpunuar 32.45 m. gj (254 kuti dhe 212 librave 204955 faqe) të materialit arkivor në fondet:

- *Kuvendi Komunal Pejë*, vitet 1953/2005;
- Gjykata Komunale Pejë, vitet 1945 – 1976
- Kuvendi Popullor Gllloxhan, Grozhdec, vitet 1945-1957<
- Kuvendi Popullor Krushec, Drelaj, vitet 1945 – 1959;
- Kuvendi Popullor Jablanicë, Leshan, vitet 1945 – 1959;
- Këshilli Popullor i K. Baran, vitet 1945 – 1959;
- Jetimorja e shkollës „Milosh Giliq“, vitet 1945 – 1959;
- Fondet me numër³ 58, 12, 20,21,82, 24,18, 66,30,13, 93, vitet pre 1945, 1999.

Arkivi Ndërkomunal Ferizaj – ka rregulluar dhe përpunuar 5.85 m.gj. (46 kuti me 25960 faqe) të materialit arkivor në fondin:

- Gjykata e Rrethit Ferizaj, vitet 1945/1962.

1.2 Mbrojtja e materialit arkivor

Përveç rregullimit dhe përgatitjes së materialeve arkivore, AShAK ka realizuar konservimin e 1423 faqe të formatit A3, ku prej tyre 218 janë restauruar, aplikuar teknika të avancuara dhe profesionale të ruajtjes. Ky proces synon mbrojtjen afatgjatë të dokumentacionit arkivor dhe sigurimin e integritetit të tij për brezat e ardhshëm.

³ Fondet të cilat janë me numër, janë bërë për arsye se janë me sasi të vogla të materialit arkivor.

8. DIGJITALIZIMI I MATERIALIT ARKIVOR

Në përputhje me objektivat strategjike të punës, prioritet i vazhdueshëm i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës për vitin 2025 dhe në vijim mbetet zhvillimi dhe konsolidimi i procesit të digjitalizimit masiv të materialeve arkivore, si pjesë e përkushtimit institucional për ruajtjen afatgjatë të trashëgimisë dokumentare dhe modernizimin e qasjes në dokumentacionin arkivor.

Ky proces trajtohet si një veprimtari e qëndrueshme dhe afatgjatë, e cila synon jo vetëm mbrojtjen fizike të materialeve arkivore, por edhe rritjen e aksesit, transparencës dhe efikasitetit në menaxhimin e tyre. Digjitalizimi përfshin një gamë të gjerë aktivitetesh të ndërlydhura, duke filluar nga identifikimi, përgatitja teknike dhe klasifikimi i materialeve, për të vazhduar me skanimin profesional, përpunimin digjital, indeksimin, krijimin e metadatave dhe ruajtjen e tyre në formate elektronike, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare për menaxhimin e dokumenteve arkivore.

Si proces i vazhdueshëm dhe prioritar edhe në vitin 2025, digjitalizimi u zgjerua gradualisht në fondet dhe koleksionet me rëndësi të veçantë historike, administrative dhe juridike, për të siguruar një qasje më të lehtë dhe më të shpejtë për studiuesit, institucionet publike dhe private, si dhe për publikun e gjerë.

Si rezultat i këtij procesi, janë digjitalizuar gjithsej gjithsej 4 793 049 faqe të materialit arkivor. Nga kjo sasi, 4 370 418 faqe janë digjitalizuar nga Operatori Ekonomik, ndërsa 422 631 faqe janë digjitalizuar nga zyrtarët e arkivit nëpër Arkivat Ndërkomunale.



Nga procesi i digjitalizimit të materialit arkivor

Po ashtu, janë identifikuar dhe përzgjedh materialet audio për digjitalizim. Me anë të paisjeve të specializuara për konvertimin e materialeve audio, janë digjitalizuar 3 kaseta të mbledhjeve nga fondi i KSAK, me një total prej 300 minutash material audio, të cilat janë ruajtur në formate MP3 dhe AU3, për të cilat është realizuar katalogimi dhe siguria e tyre.

9. ZHVILLIMI DHE ADMINISTRIMI I VEPRIMTARISË HULUMTUESE ARKIVORE

Në kuadër të modernizimit dhe digjitalizimit të shërbimeve arkivore, është realizuar krijimi dhe funksionalizimi i Platformës *Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Materialeve Arkivore* (SEMMA). Pas zhvillimit të procedurave tenderuese dhe pas instalimit dhe konfigurimit teknik, sistemi u vu në funksion dhe filloj zbatimin në disa procese operative të punës.

Pas funksionalizimit të sistemit, gjatë vitit në platformën SEMMA u integruan të dhënat bazë për 490 fonde dhe koleksione arkivore të Arkivit Qendror, duke krijuar një bazë të strukturuar për menaxhimin elektronik të materialeve. Njëkohësisht, u funksionalizua edhe moduli për hulumtuesit, përmes të cilit realizohet regjistrimi, parashtrimi i kërkesave dhe menaxhimi i procesit të hulumtimit në mënyrë elektronike. Deri më tani, në platformë janë regjistruar gjithsej 166 hulumtues, prej të cilëve 70 kanë parashtruar kërkesa për hulumtim, ndërsa 38 kanë realizuar hulumtimin.

Për të lehtësuar qasjen dhe regjistrimin në sistem, është përgatitur një udhëzues i detajuar për përdorimin e SEMMA-s, i cili është publikuar në ueb-faqen zyrtare të ASHAK, duke ofruar informacione të qarta dhe të strukturuar për të gjithë të interesuarit.

Realizimi i hulumtimeve u bë në Sallën e Hulumtimeve në ASHAK, ku hulumtuesit u shërbyen me material arkivore në formë digjitale dhe fizike.

Zbatimi i SEMMA-s ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe standardizimit të shërbimeve arkivore, duke forcuar njëkohësisht kapacitetet institucionale në drejtim të ruajtjes, administrimit dhe ofrimit të dokumentacionit arkivor në formë digjitale.



The screenshot displays the SEMMA web application interface. At the top, there is a header with the logo of the Agency for State Archives of Kosovo and the text 'AGJENCIA SHETËRORE E ARKIVAVE E KOSOVËS' and 'SISTEMI ELEKTRONIK I MENAXHIMIT TË MATERIEVE ARKIVORE'. Below the header, there is a navigation menu with 'BAGUNA' and 'BETRI'. The main content area is titled 'FONDET DHE KOLEKSIONET ARKIVORE' and contains a table with columns for 'ID', 'Emri i fondit/koleksionit', 'Vitet', 'Vitet', 'Vitet', and 'Statusi'. The table lists several archival funds and collections with their respective IDs and status indicators.

ID	Emri i fondit/koleksionit	Vitet	Vitet	Vitet	Statusi
1	FOND I SHËRBIMEVE ARKIVORE	1945	1945	1945	OK
2	ARHIVI I SHËRBIMEVE ARKIVORE	1945	1945	1945	OK
3	ARHIVI I SHËRBIMEVE ARKIVORE	1945	1945	1945	OK
4	ARHIVI I SHËRBIMEVE ARKIVORE	1945	1945	1945	OK
5	ARHIVI I SHËRBIMEVE ARKIVORE	1945	1945	1945	OK

10. SHËRBIMI I QYTETARËVE ME DOKUMENTE ARKIVORE

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës ka vazhduar më tej ofrimin e shërbimeve arkivore përmes bashkëpunimit me Postën e Kosovës, duke e konsoliduar këtë model si një praktikë të qëndrueshme dhe efikase institucionale, të iniciuar në vitet paraprake.

Ky shërbim ka vazhduar të mundësojë pranimin e aplikacioneve dhe shpërndarjen e dokumenteve arkivore në të gjitha pikat postare në vend, duke garantuar qasje të barabartë për qytetarët, pavarësisht vendbanimit të tyre. Përmes këtij sistemi, është reduktuar ndjeshëm nevoja për paraqitje fizike në institucion, duke kursyer kohë dhe duke rritur komoditetin e aplikuesve.

Pas pranimit, shqyrtimit dhe përpunimit profesional të kërkesave nga AShAK, dokumentet arkivore dorëzohen përmes Postës së Kosovës në mënyrë të sigurt, duke siguruar integritetin dhe konfidencialitetin e tyre gjatë gjithë procesit të transportit dhe dorëzimit.

Vazhdimësia e këtij modeli edhe gjatë vitit 2025 dëshmon suksesin dhe qëndrueshmërinë e tij si një mekanizëm i besueshëm për ofrimin e shërbimeve arkivore. Ky bashkëpunim ka kontribuar në rritjen e efikasitetit operacional, standardizimin e procedurave dhe forcimin e sigurisë në trajtimin e dokumentacionit arkivor, duke përmirësuar ndjeshëm. Gjatë vitit janë evidentuar 1829 kërkesa të pranuar nga qytetarët, në nivelin qendror dhe atë lokal, prej të cilave 1185 rezultuan pozitive, 299 negative dhe 305 janë në proces të realizimit. Ndërsa, 29 kërkesa ishin për hulumtime arkivore në Arkivat Ndërkomunale.

Gjatë vitit 2025, AShAK ka trajtuar me sukses edhe kërkesat për qasje në dokumente zyrtare nga qytetarë, gazetarë dhe palë të tjera të interesuara, duke siguruar një shërbim transparent dhe profesional. Këto kërkesa janë përpunuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me një përkushtim të veçantë për respektimin e të drejtës së informimit. AShAK mbetet e angazhuar në ofrimin e qasjes në dokumente arkivore dhe zyrtare, duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi.

11. BIBLIOTEKA E ARKIVIT


Përveç funksionit themelor të ruajtjes dhe menaxhimit të materialit arkivor, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës administron edhe Bibliotekën e Arkivit, e cila përmban rreth 15,000 tituj bibliotekarë, ndër të cilët një pjesë përfaqëson vlera të veçanta dhe botime të rralla me rëndësi të posaçme dokumentare dhe studimore. Gjatë kësaj periudhe është realizuar rikthimi dhe sistematizimi i plotë i koleksionit prej mbi 15,000 titujsh, të cilët ishin zhvendosur përkohësisht për shkak të punimeve rinovuese.

Në vazhdim, janë zhvilluar aktivitetet e digjitalizimit dhe katalogimit. Është realizuar skanimi i kopertinave dhe përshkrimi bibliografik, të cilët më pas janë integruar në sistemin digjital të skedarëve.

Pas konfigurimit të platformës SEMMA, ka filluar regjistrimi i titujve bibliotekarë në këtë sistem. Njëkohësisht, është realizuar edhe redaktimi dhe përditësimi i të dhënave për rreth 1,000 tituj botimesh dhe 1,300 autorë librash, me qëllim të rritjes së saktësisë dhe standardizimit të të dhënave bibliografike.

Krahas procesit të migrimit të të dhënave nga sistemi i mëparshëm digjital i katalogimit në platformën SEMMA, biblioteka ka vazhduar të ofrojë shërbime për qytetarët sipas kërkesave të paraqitura, ku janë shërbyer rreth 24 palë kërkuës.

Fondi bibliotekar është pasuruar me tituj të rinj përmes dorëzimeve nga autorët, duke shtuar gjithsej 27 tituj të rinj në koleksion.



Nga Biblioteka e ASHAK – migrimi i të dhënave në SEMMA

12. INSPEKTIMI DHE PRANIMI I MATERIALIT ARKIVOR TE FONDKRIJUESIT

12.1. Inspektimi i institucioneve fondkrijuese

Inspektimet arkivore në institucionet qendrore dhe lokale kanë qenë thelbësore për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e menaxhimit të dokumenteve dhe arkivave, duke siguruar përputhjen me legjislacionin në fuqi.

Në kuadër të këtyre inspektimeve, janë realizuar gjithsej **64 vizita** në institucione të ndryshme, duke përfshirë ministri, agjenci shtetërore, komuna dhe njësi tjera administrative. Objektivi kryesor i këtyre inspektimeve ka qenë të vlerësohet gjendja aktuale e arkivave, të identifikohen mangësitë dhe të ofrohen rekomandime për përmirësimin e menaxhimit arkivor.

12.2. Pranimi i materialit arkivor

Në kuadër të përmbushjes së mandatit ligjor për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit me vlerë të përhershme, ASHAK ka realizuar pranimin e një sasi të konsiderueshme materiale arkivore nga institucionet fondkrijuese.

Janë pranuar materiale arkivore nga komunat në veri të Kosovës, si rezultat i mbylljes së strukturave paralele dhe marrjes së fondit nga fondkrijuesit përkatës.

Materiali arkivor përfshinë dokumentacion të krijuar nga ndërmarrjet shoqërore të rajonit të Mitrovicës Veriore, si dhe nga komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, me përmbajtje të gjerë administrative, urbanistike, kadastrale, civile dhe ekonomike, me një total prej **838 kuti arkivore; 69 Libra; 204 fashikuj dhe 3 m.gj.**

Po ashtu, është pranuar materiali arkivor i AKP-së, regjioni i Pejës dhe Mitrovicës, në sasi pre **15739 kuti arkivore**, si dhe nga Banka Qendrore e Kosovës, që lidhet me veprimtarinë e Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror në sasi prej **49 m.gj.**



Nga përmbyllja e pranimi të materialit arkivor nga Komunitet Veriore të Kosovës

12.3 Lista me afate të ruajtjes

ASHAK, si institucion kompetent për administrimin e dokumentacionit arkivor, gjatë vitit 2025 ka realizuar pranimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e *Listave me Afate të Ruajtjes* të dorëzuara për marrje të pëlqimit nga institucionet fondkrijuese. Ky proces është zhvilluar në përputhje me Rregulloren (MAP) Nr. 01/2015 për Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe Afatet e Ruajtjes së tyre.

Gjatë shqyrtimit, për disa fondkrijues është kërkuar plotësimi dhe korrigjimi i listave, duke siguruar përputhjen me standardet arkivore.

Pëlqim për miratim të listave iu është dhënë institucioneve si në vijim:

1. Agjencia Kosovare për Verifikim dhe Krahësim të Pronës;
2. Komuna e Vushtrrisë;
3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
4. Instituti i Avokatit të Popullit.

Ndërsa në proces janë 9 lista me afate të ruajtjes nga:

Ibër Lepenci; Oda e Përmbaruesve të Kosovës; MPB; KPK; Telkos & TEVE 1; AKKVP; MD; Akademia e Drejtësisë dhe Policia e Kosovës.

Listat në proces, pas kontrollit dhe verifikimit, janë kthyer për plotësim dhe ndryshime, së bashku me rekomandimet përkatëse.

13. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar është thelluar përmes nënshkrimit dhe ripërtëritjes së marrëveshjeve, si dhe pjesëmarrjes aktive në aktivitete profesionale me karakter ndërkombëtar.

13.1 Marrëveshje bashkëpunimi

- Më 10 korrik 2025, u nënshkrua marrëveshja bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, me qëllim të forcimit dhe thellimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e trashëgimisë dokumentare dhe kulturore, si dhe të shkëmbimit të përvojave profesionale ndërmjet institucioneve.



Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes mes ASHAK - BKK

- Më 4 shtator 2025, u ripërtëri marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet me Shkollën e Mesme Profesionale “Hoxhë Kadri Prishtina” nga Fushë Kosova. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është mundësimi i realizimit të praktikës profesionale për nxënësit e kësaj shkolle në ambientet e ASHAK, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive praktike të nxënësve.



Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes mes ASHAK – SHMP

- Më 6 nëntor 2025, ASHAK nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin Filozofik – Departamentin e Historisë, e cila u mundëson studentëve të nivelit BA, MA dhe PhD realizimin e praktikës profesionale në ASHAK dhe qasje në burimet arkivore për qëllime hulumtuese, duke forcuar lidhjen ndërmjet studimeve akademike dhe praktikës arkivore.



Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes mes ASHAK – Fakulteti Filozofik

13.2 Konferenca ndërkombëtare

Organizimi i Konferencës IX Mbarëkombëtare të Arkivistikës

Më 15 qershor 2025, Arkivi Shtetëror i Kosovës (AShAK), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë dhe Komunën e Shën Mitrit (San Demetrio Corone), organizoi Konferencën IX Mbarëkombëtare të Arkivistikës, e cila u mbajt në Shën Mitër, Itali.

Ky forum shkencor mbledhi studiues, hulumtues dhe përfaqësues të institucioneve arkivore nga të gjitha trevat shqiptare, si dhe nga diaspora arbëreshe, duke shërbyer si platformë për shkëmbimin e përvojave profesionale dhe diskutimin e çështjeve aktuale të arkivistikës.

Gjatë konferencës u prezantuan gjithsej 33 kumtesa, të cilat trajtuan tema të rëndësishme si menaxhimi i trashëgimisë dokumentare, digjitalizimi, ruajtja afatgjatë e materialeve arkivore, si dhe problematika të tjera që lidhen me punën profesionale me dokumente arkivore. Një fokus i veçantë iu kushtua komunitetit arbëresh dhe rolit të tij në ruajtjen dhe transmetimin e identitetit kulturor shqiptar.

Ky aktivitet konfirmoi përkushtimin e AShAK-së për forcimin e bashkëpunimit ndërshqiptar, promovimin e trashëgimisë dokumentare dhe pjesëmarrjen aktive në rrjetet shkencore dhe profesionale të arkivistikës.



Nga Konferenca IX Mbarëkombëtare të Arkivistikës, Shën Miter - Itali

- **21–23 maj 2025:** Delegacioni i AShAK-së mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare me temën “*Problemet teknike dhe sfidat në fushën e arkivimit tradicional dhe elektronik*”, e mbajtur në **Radenci, Slloveni**.



Nga Konferenca *Problemet teknike dhe sfidat në fushën e arkivimit tradicional dhe elektronik* - Radenci

- **1–2 shtator 2025:** Institucioni u përfaqësua në konferencën ndërkombëtare “*Digitise.Transform.Inspire (DTI 2025)*”, e mbajtur në **Vjenë, Austri**, ku u diskutuan praktikatat më të avancuara në fushën e arkivave dhe trashëgimisë kulturore digjitale.



Gjatë pjesëmarrjes në Konferencës DTI - Vjenë

- **27–30 tetor 2025:** Pjesëmarrësit nga AShAK ishin të pranishëm në **Kongresin Ndërkombëtar të Arkivave – ICA Barcelona 2025**, një nga ngjarjet më të rëndësishme globale në fushën e arkivistikës.



Nga Kongresi Ndërkombëtar i Arkivave – ICA Barcelona 2025

- **12–14 nëntor 2025:** Zyrtarë të AShAK-së morën pjesë në **Konventën e 35-të të ICARUS-it**, e mbajtur në **Arkivin Shtetëror të Venecias**, ku u diskutuan praktikat bashkëkohore të menaxhimit arkivor dhe mundësitë për bashkëpunim ndërinstytucional në nivel evropian.



Gjatë pjesëmarrjes në Konferencës - Venecia

- Po ashtu më 10 mars 2025, AShAK mori pjesë në **Konventën e 35-të të ICARUS-it**, e mbajtur në Arkivin Shtetëror të Venecias, e mbajtur në platformën **Zoom**. Qëllimi kryesor i takimit ishte zgjedhja e bordit të ri drejtues; megjithatë, për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm, procesi i votimit u shty për një datë tjetër.

13.3 Takime dhe vizita zyrtare

Ka vazhduar intensifikimi i bashkëpunimit si në nivel vendor, ashtu edhe në atë ndërkombëtar, duke realizuar vizita zyrtare, takime koordinuese dhe aktivitete të përbashkëta me institucione të rëndësishme të fushës së kulturës, arsimit dhe shkencës.

- Në kuadër të mbështetjes së institucioneve qendrore, ASHAK u vizitua më 6 maj 2025 nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili u njoh nga afër me ecurinë e punimeve rinovuese dhe investimeve infrastrukturore në objektin qendror të ASHAK-së në Prishtinë.



Nga vizita e Ministrit Çeku në ASHAK

- Më 22 maj 2025, Kryeministri i Republikës së Kosovës, i shoqëruar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit realizuan një vizitë pune për të parë progresin e deritanishëm dhe për të diskutuar fazat e ardhshme të modernizimit të plotë të infrastrukturës arkivore kombëtare.



Nga vizita e Kryeministrit të Republikës së Kosovës

- Më 29 prill 2025, Drejtori Ekzekutiv i ASHAK-ut, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, zhvilloi një takim zyrtar me Kryetarin e Komunës së Leposaviqit për pranimin e materialit arkivor të kësaj komune (viti 1956). Ky veprim është pjesë e përmbushjes së obligimeve ligjore për dorëzimin dhe administrimin e dokumentacionit komunal, duke garantuar ruajtjen afatgjatë dhe menaxhimin profesional të fondit arkivor në përputhje me standardet bashkëkohore.



Nga vizita në Komunën e Leposaviqit

- Një tjetër drejtim i rëndësishëm i bashkëpunimit nderinstitucional ka qenë koordinimi me institucionet kulturore e shkencore, si Bibliotekën Kombëtare e Kosovës, Muzeun Kombëtar të Kosovës dhe Institutin për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë. Këto takime u fokusuan në planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta për shënimin e 12 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Kosovës, përmes ekspozitave, prezantimeve dhe nismave që synojnë promovimin e trashëgimisë dokumentare të periudhës së luftës.



Nga aktiviteti për shënimin e 12 qershorit – Ditës së Çlirimit

- Në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar, më 5 maj 2025, Drejtori Ekzekutiv i ASHAK-ut, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, realizoi një vizitë zyrtare në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, ku u prit nga zëvendës drejtori Endrit Musaj. Takimi u përqendrua në çështje të rëndësishme si modernizimi i institucioneve arkivore, digjitalizimi i fondit dokumentar dhe shkëmbimi i praktikave profesionale. Palët u dakorduan gjithashtu për detajet e organizimit të Konferencës së 9-të Mbarëkombëtare të Arkivistikës, si një aktivitet tradicional i përvitshëm që synon të lidhë institucionet arkivore nga të gjitha trevat për të shkëmbyer përvoja, praktika dhe standarde në menaxhimin e trashëgimisë dokumentare.



Nga vizita zyrtare në Tiranë

- Gjithashtu, bashkëpunimi ndërinstitucional është zgjeruar edhe në fushën e arsimit profesional. Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet ASHAK-ut dhe Shkollës së Mesme “Hoxhë Kadri Prishtina” në Fushë Kosovë, ka vazhduar zhvillimi i praktikës profesionale për nxënësit në ambientet e ASHAK-së. Kjo praktikë është organizuar në mënyrë të strukturuar dhe nën mbikëqyrje profesionale, duke u ofruar nxënësve mundësi konkrete për zhvillimin e aftësive praktike. Për këtë kontribut, ASHAK është vlerësuar me mirënjohje nga drejtorja e shkollës, çka dëshmon suksesin e bashkëpunimit dhe angazhimin për përgatitjen e kuadrove të rinj profesionalë.



Nxënësit praktikant në ASHAK

- Në periudhën 1–4 dhjetor 2025, u.d. Drejtori Ekzekutiv i ASHAK-së, z. Bekim Aliu, së bashku me bashkëpunëtorë, realizoi një vizitë zyrtare në Arkivin Osman në Stamboll, ku u prit nga Presidenti i Arkivave të Turqisë, Doç. Dr. Muhammet Ahmet Tokdemir, si dhe nga drejtues të tjerë të Arkivave Shtetërore të Presidencës së Turqisë. Qëllimi i vizitës ishte thellimi i bashkëpunimit në mes institucioneve arkivore, zhvillimi i projekteve të përbashkëta, si dhe realizimi i hulumtimeve arkivore në Arkivin Osman. Si rezultat i këtyre hulumtimeve, u siguruan mbi 13.000

dokumente arkivore digjitale që lidhen me historinë e Kosovës dhe trevave shqiptare, duke pasuruar fondin dokumentar të ASHAK-së.



Nga vizita zyrtare në Arkivin Osman - Stamboll

14. PROMOVIMI I VEPRIMTARISË ARKIVORE

Promovimi i veprimtarisë së ASHAK realizohet përmes aktiviteteve institucionale, ekspozitave, botimeve shkencore dhe pjesëmarrjes në panaire dhe media elektronike.

14.1 Ekspozita

Më 14 shkurt, u hap ekspozita “Komiteti – Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, e organizuar në bashkëpunim me shkollën *Kosovo Leadership Academy – Mitrovicë*. Ekspozita qëndroi e hapur për tre ditë dhe u realizua me rastin e shënimit të 17-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, duke prezantuar dokumente të rëndësishme që reflektojnë përpjekjet historike për mbrojtjen e çështjes kombëtare.

Më 11 qershor të po këtij viti, në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, u organizua ekspozita “Nga lufta në liri: Çlirimi i Kosovës në dokumente, kujtime dhe medie”, në bashkëpunim me Institutin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë dhe Muzeun e Kosovës. Përmes dokumenteve arkivore, fotografive, dëshmimeve mediatike dhe kujtimeve të periudhës së luftës, ekspozita pasqyroi rrugëtimin historik të popullit të Kosovës drejt çlirimit dhe lirisë.



Nga ekspozita “Nga lufta në liri: Çlirimi i Kosovës në dokumente, kujtime dhe medie”,

Pak ditë më vonë, më 17 qershor, u hap ekspozita “Luigj Gurakuqi në dokumente arkivore” në Arkivin Shtetëror të Barit (Itali), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë dhe Arkivin e Barit, në kuadër të shënimit të 100-vjetorit të vrasjes së Luigj Gurakuqit. Ekspozita prezantoi dokumente historike që ndriçojnë jetën dhe veprimtarinë e tij në historinë kombëtare.



Nga ekspozita “Luigj Gurakuqi në dokumente arkivore” në Arkivin Shtetëror të Barit -Itali

Më 26 nëntor 2025, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, në praninë e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, u hap ekspozita “Koha e shndërrimit: Kosova 1968–1981 – dokumente dhe dëshmi”, me rastin e Festës së Flamurit. Ekspozita ofroi një pasqyrë të zhvillimeve shoqërore, politike dhe kulturore të kësaj periudhe të rëndësishme në historinë e Kosovës.



Nga ekspozita “Koha e shndërrimit: Kosova 1968–1981 – dokumente dhe dëshmi”


Në kuadër të Javës së Kulturës Kombëtare, ekspozita “Nga lufta në liri” u ri-hap në Qendrën “Sotir Kolea” të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, duke mundësuar shtrirjen e saj edhe për publikun në Shqipëri dhe duke kontribuar në promovimin e kujtesës historike dhe bashkëpunimit ndërinstitucional kulturor.



Nga ekspozita “Nga lufta në liri”, ri-hap në Qendrën “Sotir Kolea” të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë

14.2 Botime dhe promovime

Gjatë vitit 2025, revista “Arkivat Shqiptare” vijoi traditën e saj në promovimin e arkivistikës dhe studimeve shkencore. Numri 61, një botim i përbashkët i ASHAK dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, përmbledh 21 kumtesa shkencore të **Konferencës IX Mbarëkombëtare të Arkivistikës**. Promovimi i numrit 60 u zhvillua në 24 prill 2025, gjatë Panairit Mbarëkombëtar të Librit Akademik në Prishtinë.



Nga promovimi i revistës Arkivat Shqiptare nr. 60, në Prishtinë

Ndërsa, promovimi i **numrit 61** u realizua më 17 dhjetor 2025 në Tiranë, duke ofruar një platformë për shkëmbimin e përvojave dhe njohurive ndërinstytucionale në fushën e arkivistikës.




Nga promovimi i revistës Arkivat Shqiptare nr. 61, Tiranë

Gjithashtu, gjatë vitit u përgatitën dhe u publikuan katalogë për ekspozitat të rëndësishme: “Koha e shndërrimit: Kosova 1968–1981 – dokumente dhe dëshmi” dhe “Nga lufta në liri: Çlirimi i Kosovës në dokumente, kujtime dhe media”, ky i fundit në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, Institutin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës dhe Muzeun e Kosovës, duke dokumentuar dhe promovuar trashëgiminë historike dhe kulturore të Kosovës në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme për publikun.

14.3 Panairi i librit

Gjatë vitit 2025, ASHAK mori pjesë aktivisht në panairët më të rëndësishme të botimeve akademike dhe shkencore. Nga 23 deri më 25 prill 2025, u organizua Panairi i Katërt Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor në Prishtinë, ku ASHAK prezantoi 33 tituj të botimeve institucionale, duke përfshirë përmbledhje dokumentesh arkivore, katalogë tematikë dhe studime bashkëpunuese, duke promovuar kështu arkivistikën dhe trashëgiminë kulturore për publikun akademik dhe profesional.



Nga panairi i librit në Prishtinë

Nga 25 deri më 26 shtator 2025, ASHAK mori pjesë në Panairin e Librit Akademik dhe Shkencor, i zhvilluar në kuadër të Seminarit XIX Ndërkombëtar të Albanologjisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Gjatë këtij panairi, u prezantuan 31 tituj botimesh të ASHAK-së, duke përfshirë promovimin e Revistës “Arkivat Shqiptare” numri 60, aktivitet ky që kontribuoi në forcimin e bashkëpunimit profesional dhe promovimin e studimeve arkivore në hapësirën shqiptare.



Nga panairi i librit në Tetovë

14.4. Java e Arkivit të Hapur (17–21 mars 2025)

U organizua aktiviteti tradicional “Java e Arkivit të Hapur”, me qëllim promovimin e pasurisë arkivore dhe informimin e publikut mbi rolin e institucionit në ruajtjen e trashëgimisë dokumentare.

Në 17 mars, java u hap zyrtarisht me një ceremoninë ku morën pjesë Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Albin Kurti, Ministri i MKRS-së z. Hajrulla Çeku, si dhe personalitete të tjera institucionale dhe kulturore. Gjatë këtij eventi u prezantuan arritjet kryesore të ASHAK: finalizimi i kuadrit ligjor për arkivat, Strategjia Shtetërore për Arkiva, avancimet në digjitalizim, lansimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Materialit Arkivor, si dhe përmirësimet e infrastrukturës fizike dhe digjitale. Kryeministri, z. Albin Kurti, vlerësoi rëndësinë e arkivave dhe shprehu mirënjohje për punën e institucioneve në këtë fushë.



Nga Java e Arkivit të Hapur - 74 vjet Arkiv



Pamje nga lansimi i plantformës SEMMA



Në 18 mars u organizua workshopi **“Digjitalizimi i Arkivave”**, i cili trajtoi sfidat e ruajtjes dhe qasjes në dokumente në epokën digjitale.



Më 19 mars, fokusi ishte tek **“Restaurimi dhe Konservimi”**, ku u zhvilluan teknika për ruajtjen fizike të dokumenteve dhe trashëgimisë dokumentare.



Në 20 mars, vazhdoi workshopi i titulluar **“Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Materialeve Arkivore”** prezantoi funksionalitetet e sistemit elektronik, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të administratës arkivore.



Java u mbyll më 21 mars me Ditën e Hulumtuesve, përmes një tryeze të hapur mbi temën “Arkivat, thesar i dijes”, ku u diskutua roli i arkivave si burim i dijes dhe i historisë për komunitetin akademik dhe publikun e gjerë.



Gjatë Javës së Hapur të Arkivit 2025, u organizuan edhe vizita edukative për nxënës dhe studentë, ku rreth 1,400 pjesëmarrës u njohën me proceset kryesore arkivore, përfshirë përpunimin, digjitalizimin, restaurimin dhe ruajtjen fizike të dokumenteve.



Vizita edukative nga nxënës të tri shkollave fillore, u mundësuan edhe gjatë vitit, duke u ofruar mundësi të njohin misionin, funksionet dhe rëndësinë institucionale të arkivave në ruajtjen e trashëgimisë dokumentare.

Promovimi institucional u zhvillua edhe përmes mediave elektronike dhe rrjeteve sociale, duke siguruar publikimin e përmbajtjeve informative dhe multimediale që evidentojnë aktivitetet, projektet dhe arritjet e institucionit gjatë gjithë vitit.

15. PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe përmirësimit të politikave zhvillimore institucionale, AShAK ka hartuar dhe miratuar një sërë dokumentesh strategjike, plane veprimi dhe raporte pune. Këto dokumente synojnë të sigurojnë transparencë, rritje të efikasitetit në menaxhim, si dhe zhvillim të qëndrueshëm institucional.

Me qëllim të garantimit të një menaxhimi të strukturuar dhe në përputhje me objektivat dhe prioritetet institucionale, janë hartuar dhe miratuar dokumentet si në vijim

- **Plani i Performancës së AShAK-së për vitin 2026**, si dokument bazë për planifikimin e objektivave dhe treguesve të performancës institucionale;
- **Plani i AShAK-së për zbatimin e Planit Kombëtar për Zhvillim (PKZH) 2026–2028**, i cili përcakton kontributin institucional të AShAK-së në realizimin e prioriteteve zhvillimore kombëtare;
- **Plani vjetor i punës së AShAK-së për vitin 2026**, që definon prioritetet institucionale, aktivitetet kryesore dhe afatet e zbatimit;
- **Përditësimi i Planit të Integritetit të AShAK-së për vitin 2026**, i realizuar në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK)2026;

Për të vlerësuar progresin dhe për të siguruar implementimin efektiv të objektivave të përcaktuara, janë përgatitur:

- **Raportet periodike dhe vjetore mbi zbatimin e Planit të Performancës**, të cilat vlerësojnë shkallën e realizimit të objektivave strategjike dhe masave të planifikuara për vitin 2025;
- **Raportet periodike mbi zbatimin e Planit Kombëtar për Zhvillim 2025–2027**, që pasqyrojnë kontributin konkret të AShAK-së në zbatimin e politikave zhvillimore kombëtare;
- **Raportet gjashtëmuajore mbi zbatimin e Planit të Integritetit në AShAK**, me fokus në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë;
- **Raportet periodike dhe vjetore të punës së AShAK-së**, si instrumente standarde të raportimit institucional;
- **Analizat e raporteve periodike dhe vjetore të punës**, të cilat paraqesin shkallën e realizimit të aktiviteteve, identifikojnë sfidat dhe ofrojnë rekomandime për përmirësim të vazhdueshëm;
- **Raporti vjetor për Qasje në Dokumente Zyrtare**, i hartuar për raportim në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e transparencës institucionale.

Përmes hartimit dhe zbatimit të këtyre planeve dhe raporteve është synuar forcimi i kapaciteteve institucionale, avancimi i praktikave të menaxhimit dhe administrimit të burimeve arkivore, si dhe sigurimi i një qasjeje të lehtë, të sigurt dhe efikase në dokumentacionin arkivor.

16. BUXHETI DHE FINANCAT

Bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, buxheti fillestar i alokuar për Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, për vitin fiskal 2024 ishte **1,571,274.00 euro**. Nga ky buxhet është planifikuar mbështetje për realizimin e objektivave të institucionit, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës arkivore, digjitalizimin e materialeve arkivore dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike.

Raporti për buxhetin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës për vitin 2024 përfshinë detaje mbi:

- Buxhetin fillestar të planifikuar;
- Lëvizjet buxhetore, duke përfshirë transferimet, rialokimet dhe lirimin e mjeteve sipas kërkesave specifike;
- Të hyrat vetanake të gjeneruara gjatë periudhës raportuese;
- Shpenzimet totale, të pasqyruara edhe në përqindje për të ilustruar shkallën e realizimit të buxhetit.

Kjo përmbledhje ofron një pasqyrë të qartë dhe transparente të menaxhimit financiar të institucionit gjatë vitit në fjalë.

Nr.	Kategoria Ekonomike	Fondi	Buxheti Fillestar (€)	Transferet (€)	Buxheti Përfundimtar (€)	Shpenzimet (€)	Realizimi (%)
1	Pagat & Mëditjet	10	761,844.00	186,434.85	948,278.85	948,278.85	124.471526
2	Mallrat & Shërbimet	10	219,910.00		219,910.00	194,941.87	88.6462053
3	Mallrat & Shërbimet	21	31,090.00	/	30,090.00	6,449.46	21.4338983
4	Mallrat & Shërbimet	22	/		1,623.62	1,619.18	99.726537
5	Komunalet	10	27,585.00		18,585.00	14,305.80	76.9749798
6	Kapitalet	10	600,000.00	219,501.00	773,155.00	740,711.29	90.38
	Totali i Buxhetit		1,571,274.00	405,935.85	1,991,642.47	1,906,306.45	95.72

17. PROKURIMI

Pas miratimit të buxhetit, për vitin fiskal 2025, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës ka përgatitur dhe dorëzuar Planifikimin Final të Prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP). Ky proces është realizuar në përputhje me kërkesat e njëjësive kërkuese (departamenteve) dhe aprovuar nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Bazuar në Planin e Prokurimit, gjatë vitit janë realizuar procedura të ndryshme të prokurimit, duke siguruar përmbushjen e nevojave institucionale dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike. Për çdo aktivitet të realizuar, janë gjeneruar urdhërblertjet përkatëse nga Sistemi i Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës (SMFPK). Këto urdhërblertje janë përdorur për të mbuluar shpenzimet e prokurimit, bazuar në kontratat e nënshkruara me operatorët ekonomikë.

Në përfundim të vitit, është përgatit Raporti i Prokurimeve për vitin fiskal 2025 dhe është hartuar Plani i Prokurimit Publik për vitin 2026, i cili është dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit Publik, duke përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe procedurale.

Ky proces reflekton përkushtimin e AShAK-së për të siguruar transparencë, efikasitet dhe përgjegjshmëri në menaxhimin e fondeve publike.